

## AKT THEMELIMI

1. – Personi juridik "RESS" sh.p.k me seli ne Elbasan, Bradashesh BRADASHESH "Ura e Kushes", zona kadastrale 2124, pasuria nr.7/1/1, njesi ND2 93.7m2, Shqiperi, mbështetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ne legjislacionin shqiptar ne përgjithësi, vendosen si vijon:

### KREU I - EMERTIMI, SELIA DHE AFATI I SHOQERISE

#### NENI 1

- 1.1 Te themelojë shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar, për te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e te cilës rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar- ne fuqi.

#### NENI 2

- 2.1 Shoqëria do te emërtohet "RESS" sh.p.k.

#### NENI 3

- 3.1 Shoqëria do te ketë Selinë e saj ne Elbasan Bradashesh BRADASHESH "Ura e Kushes", zona kadastrale 2124, pasuria nr.7/1/1, njesi ND2 93.7m2
- 3.2 Selia e shoqërisë mund te transferohet.

#### NENI 4

- 4.1 Shoqëria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve.
- 4.2 Shoqëria "RESS" sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

#### NENI 5

- 5.1 Shoqëria "RESS" sh.p.k do te ketë si objekt:
- Blerje dhe shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.
  - Menaxhim dhe dhenie me qira te skeleve apo materiale ndertimore te ndryshme.
  - Punime te ndryshme ndertimore

Gjithashtu, Shoqëria mund te kryeje çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te çfarëdo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme për arritjen e objektivit te shoqërisë, qe nuk ndryshon aktivitetin parësor te shoqërisë dhe nuk bie ne kundërshtim e legjislacionin shqiptar ne fuqi.

#### NENI 6



1

- 6.1 Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesën e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.
- 6.2 Ortakët themelues përballojnë humbjet shoqërisë deri ne kufirin e vlerës se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne bankat e Shtetit Shqiptar.
- 6.3 Kapitali themeltar për vazhdimin e aktivitetit te shoqërisë është ne shumen 100,000 (njqind mijë) leke, qe i takon ortakut te vetem themelues si me poshtë:
- (a) Personi Juridik "Ankor" Sh.p.k zotëron 1 kuote, me vlere 100 % te kapitalit.
- 6.4 Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave mund te ndahen si vijon:
- (a) Fondi rezerve.
  - (b) Shpërblimi qe i takon ortakeve themelues.

#### NENI 7

- 7.1 Shoqëria mund te hyje ne veprimtari te përbashkëta me shoqëri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti atë te shoqërisë.

#### NENI 8

- 8.1 Veprimtaria shoqërisë mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

### KREU II - TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

#### NENI 9

- 9.1 Ortaku gëzon këto te drejta kryesore:
- (a) Administrimin e veprimtarisë ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.
  - (b) Pjesëmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasje te veprimtarisë se shoqërisë e parashikuar ne statutin e saj.
  - (c) Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe organet e tjera te shoqërisë.
  - (d) Te heqë dore nga shoqëria. Heqja dore nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqërisë.
  - (e) Te marri pjese ne organet e shoqërisë qe janë ose mund te krijohen nëpërmjet përfaqësuesit te tij ose vete.
  - (f) Te emëroje dhe te shkarkoje përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.
- 9.2 Ortaku ka këto detyrime kryesore:
- (a) Te depozitoje kuotën e tij dhe kuotën suplementare ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.
  - (b) Te marri pjese ne administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve te krijuara nga vete ata.

- (c) T'i japi shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të veçante lidhur me veprimtarinë e saj.
- (d) Te kryeje detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- (e) Ka detyrimin nëse heq dorë nga shoqëria të njoftojnë vendimin e tij asamblesë 3 muaj përpara dhe duke çduar të drejtën e zgjedhjes.
- (f) Te kryeje shërbimet e domosdoshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

### KREU III – ADMINISTRIMI

#### NENI 10

- 10.1 Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.

#### NENI 11

- 11.1 Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm.
- 11.2 Në shoqërinë "RESS" sh.p.k administrator i shoqërisë do të jetë Z. Ervis Deda, atësia Hiqmet, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan, me datë 26.11.1983 dhe banues në Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I31126050U madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar.
- 11.3 Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare.
- 11.4 Me miratimin e ortakeve mund të emërohen administratore dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë. Administratorët emërohen për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm.
- 11.5 Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë

### KREU IV - MBYLLJA E SHOQËRISË

#### NENI 12

- 12.1 Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bere nga ortaku, kur gjatë tre vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë.
- 12.2 Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

#### NENI 13

- 13.1 Kur shoqëria likuidohet Asambleja e ortakut emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të këtij bilanci të likuidimit. Komisioni i Likuidimit përbehet nga një ose tre natarë. Pasuritë që janë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre.



Mjetet financiare te fituara si rezultat veprimtarisë se shoqërisë e te filialeve te saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakeve ne përpjesëtim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat për kreditoret.

#### NENI 14

- 14.1 Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve.
- 14.2 Likuidimi i filialeve behet njëllonj si për shoqërinë.
- 14.3 Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarisë se filialit te likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqërisë pasi to jene bere pagesat likuidatorëve.

#### NENI 15

- 15.1 Dispozita te hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt-Themelimi nënshkruhet me vullnet te lire ne 1 kopje identike ne gjuhen shqipe, dhe secili nga ortakët do te marre një kopje.

### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Ankor sh.p.k,



Përfaqësuar nga Z.Ervis Deda,

Administrator

